



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 96 Datë 26.10.07

PËR

MIRATIM FONDI TË NDËRTIMIT TË SISTEMIT TË NGROHJES
NË TEATRIN A.Z.CAJUPI

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Punëve Publike «PËR MIRATIM FONDI TË NDËRTIMIT TË SISTEMIT TË NGROHJES NË TEATRIN A.Z.CAJUPI», bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K.B. nr 92 dt.27.12.2006 « Për përcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitin 2007 », si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 2.220.000 lekë për ndërtimin e sistemit të ngrohjes në Teatrin A.Z.Cajupi.

2. Ky fond do të perballohet nga fondi i planifikuar i vitit 2007 në buxhetin e Teatrit dhe konkretisht:

- 2.000.000 lekë do të përballohen nga shpenzimet operative të Teatrit (në zërin karburant për kaldajën).
- 220.000 lekë do të përballohen nga fondi i planifikuar për paga për Teatrin me këtë strukturë buxhetore:

<i>Pakësohet</i>	<i>00</i>	<i>08250 05</i>	<i>Art 6020000</i>	<i>- 2.000.000 lekë</i>
<i>Pakësohet</i>	<i>00</i>	<i>08250 05</i>	<i>Art 6000000</i>	<i>- 220.000 lekë</i>
<i>Shtohet</i>	<i>00</i>	<i>08250 05</i>	<i>Art 2310000</i>	<i>+ 2.220.000 lekë</i>

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës. Drejtoria e Punëve Publike, Drejtoria Juridike në Bashki dhe institucioni i Teatrit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE